



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më .02.2024

**Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall**

*(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS - “Furnizim Vendorsje panele diellore ne ndertesën e rikonstruktuar te Bashkise Elbasan”**

**LLOJI PROCEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar – mallra”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Panele diellore- Kodi **09331000-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT - 4’169’200** (katërmilion e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntëmijë e dyqind) **lekë pa t.v.sh.**

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si mëposhte:

**Shtojca 7**

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

**Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.**

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e

nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

*b. Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Kriteri (1-a) është vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”

Kriteri (1- b) është vendosur në baze të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Kriteri (1-c) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:**

Sipas shtojcës 7;

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifatat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

**2.2.2** Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, ku vlера e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete **jo me e vogel se 40 % e fondit limit te prokuruar.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

### **2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime dhe instalime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vleres se perlloritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.**

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e pervojес se meparshme te realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara,

#### **ose**

- b) **Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”. Vendosija e ketij

kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues ka përvojën e duhur per te permbushur me sukses kontraten.

### 2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

- **N.P- 10 A** Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.
- **N.P-11 A** Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojne nga vendi i origjinës pranë Institucionit perkates , ne plotesimin te licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontratës.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku jane te percaktuar kategorite perkatese dhe niveli i klasifikimit per licensat e subjekteve qe ushtrojn veprimtari ne fushen e ndertimit.

*Pikat e licensave jane percaktuar ne baze te zerave te pershkruara ne preventivin e projektit..*

*Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.*

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
<i>NP-10</i>	<i>Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike</i>	<i>Punime për instalimin e sistemit fotovoltaiq per prodhim energjie</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>
<i>NP-11</i>	<i>Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike</i>	<i>Punimet per instalimin e panelit elektrik dhe lidhjen me rrjetin</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si mëposhtë :

- 1 (nje) punonjës Ing. Elektrik
- 2 (dy) punonjes elektriciste
- 2 (dy) punonjes instalues te paneleve diellore fotovoltaike
- 1 (nje) punonjes elektroteknik
- 1 (nje) punonjes elektromekanik
- 1 (nje) punonjes saldator

Për ing.elektirik duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe diploma per Inxhinieri Elektrike si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit

Për punonjësit tjere duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe certifikatat/diplomat/deshmia te leshuara nga institucione publike/private te licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH“, i ndryshuar, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjesit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin, specifikimet teknike dhe zërat e preventivit, duke krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Inxhinieri elektrik** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve per instalimin e panelit elektrik, lidhjen me rrjetin elektrik dhe testimin dhe venien ne pune te sistemit siç parashikohet ne projekt.
- **Punonjesi instalues i paneleve diellore fotovoltaike** është i nevojshem për realizimin e punimeve të instalimit te paneleve fotovoltaike.
- **Punonjes elektroteknik** - është i nevojshem për konfigurimin e sistemit.
- **Elektracist** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjes elektromekanik** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve te struktures se montimit sipas projektit dhe zërave të preventivit të punimeve.
- **Saldatori** është i nevojshëm për realizimin e punimeve te saldimit te struktures se montimit sipas projektit dhe zërave të preventivit të punimeve.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar mesatarisht **10** (dhjetë) punonjes për tre muajt e fundit, të vërtetuar me :

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjësit e mesipër do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Kriteri 2.3.4 bazohet në Nenin 40 pika 5, germa b) dhe c) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe është vendosur duke pasur parasysh punimet që do të kryhen për furnizimin dhe instalimin e pajisjeve, si dhe punonjësit e kualifikuar dhe ndihmes që duhen për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.5** Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (I ndryshuar).
- 2 (dy) punonjës/specialistë të çertifikuar për “*Punime në lartësi*”, sipas VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, e dhënë nga një organizem i licencuar çertifikimi shqiptar ose i huaj.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Këto kritere janë vendosur në mbështetje të Ligjit 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve si dhe 2 punonjës të jenë të çertifikuar apo trajnuar për punimet në lartësi, kjo në përputhje me natyrën dhe vendin e kryerjes së punimeve, i cili do të jetë tarraca e godinës së bashkise.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të **disponojë një automjet të përshtatshëm për transport me kapacitet mbajtës minimalisht 1.5 ton**, për transportin e mallit objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- **Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;**
- **Kontratën noteriale te marrjes me qira të mjetit,** shoqëruar me dokumentacionin përkatës tëpronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

ose

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjetit, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Kriteri 2.3.6 është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga sasitë e mallit që janë kërkuar si dhe pesha e tyre është parë e nevojshme të kërkohej një automjet i përshtatshëm me tonazh minimalisht 1.5 ton.

### **2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë certifikatat të vlefshme:**

- SSH/EN-ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente, e vlefshme dhe të perputhet me mallin objekt prokurimi.
- SSH/EN-ISO 45001-2018 "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë" ose ekuivalent.

Çertifikata e mesiperme duhet të jete e leshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kriteri 2.3.7 është vendosur në perputhje me Nenin 40 pika 6 germa c të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar në nenin 79 të LPP.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë



të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Ky kriter është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertojë të jetë i pajisur me certifikatën e menaxhimit të cilësive gjë e cila krijon bindjen dhe sigurinë të AK që ky OE do të ofertojë produkte të certifikuar të një cilësie të mirë e në përputhje me standartet ndërkombëtare të cilësive.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi, ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori për pajisjet objekt prokurimi shoqëruar me certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku të dallohen qarte specifikimet teknike të saj. Në rastin e autorizimit të distributorit duhet paraqitur dhe marrëveshja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Secili nga dokumentat e paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website në rast verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kriteri **2.3.8** është vendosur në përputhje me nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin **40** pika **6** germa **b** dhe pika 8 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është vendosur që operatori ekonomik që do të ofertojë të garanton AK që ka ose do të ketë në dispozicion mallin objekt prokurimi si dhe do ta furnizojë atë me mallra cilësorë dhe në përputhje me specifikimet teknike.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave që do të ofertojnë, është kërkesë ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, apo marrëveshje bashkëpunimi, duke treguar origjinalitetin e tyre dhe ofruar garanci për mallrat që do të furnizohen.

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës së prokurimit, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës. Gjithashtu OE duhet të paraqesin fotografi/katalogë/broshurë për disa nga artikujt e objektit të prokurimit, ku të shprehin qartë llojin e mallit që ofertojnë, për të gjykuar nëse mallrat që do të lëvrohen nga operatorët ekonomikë janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe se OE do të furnizojë me ato mallra që ka paraqitur në ofertën e tenderit dhe për të cilën do të jetë shpallur fitues.

**2.3.9** Operatori ekonomik, që të vërtetojë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, duhet të paraqesë raportet e testimit për pajisjen "Modul monokristalor 550 W" të lëshuara nga institucione të autorizuar/certifikuara.

**Argumentimi:** Kriteri **2.3.9** është vendosur referuar nenit 40, pika 6, germa c, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe bazuar në nenin 77 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Kërkesa është propozicion me natyrën dhe përmasat e kontratës si dhe me projektin, duke qenë se kjo është edhe pajisja kryesore e sistemit, duke garantuar AK për cilësinë e produktit.

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, në të cilën do të japë garanci për pajisjet objekt prokurimi sipas afateve të percaktuara në specifikimet teknike.

**Argumentimi:** Kriteri **2.3.10** është vendosur në përputhje me Nenin 40 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe bazuar në nenin 79 të LPP. Ky kriter është vendosur që AK të ketë siguri që operatori ekonomik do të ofertojë produkte të certifikuar të një cilësie të mirë e në përputhje me standartet ndërkombëtare të cilësisë si dhe të marrë përsipër riparimin apo zëvendësimin e tyre gjatë periudhës së garancisë.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".